



PROKURORIA THEMELORE GJAKOVË

BULETINI
Janar – Mars 2025



Përmes këtij buletini pasqyrohen aktivitetet kryesore, të cilat janë realizuar në Prokurorinë Themelore në Gjakovë, për periudhën kohore Janar-Mars 2025

Prokuroria Themelore Gjakovë gjatë vitit 2024 ka ngritur 256 aktakuza për veprën penale “Dhuna në familje”



PROKURORIA THEMELORE GJAKOVË

**PROKURORIA THEMELORE GJAKOVË GJATË
VITIT 2024 KA NGRITUR 256 AKTAKUZA PËR
VEPRËN PENALE “DHUNA NË FAMILJE”**



Gjakovë, 17 janar 2025

Gjatë vitit 2024, Prokuroria Themelore në Gjakovë, ka ngritur dyqind e pesëdhjetë e gjashtë (256) aktakuza, si dhe nga gjykatat janë pranuar njëqind e gjashtëdhjetë e gjashtë (166) aktgjykime dënuese për veprën penale “Dhuna në familje”.

Prokuroria Themelore në Gjakovë, mbetet e angazhuar për të siguruar drejtësi dhe për të ndjekur penalisht të gjithë ata që shkelin ligjin, duke vazhduar me përkushtim në misionin e saj për të mbrojtur qytetarët dhe të drejtat e tyre.

Prokuroria Themelore në Gjakovë, do të vazhdojë t'i trajtoj me seriozitet të gjitha rastet e dhunës në familje, duke ndërmarrë të gjitha veprimet e nevojshme për të parandaluar dhe luftuar veprat penale të kësaj natyre.

Ndalohe tre persona për 48 orë për marrje ryshfeti



Gjakovë, 20 janar 2025

Prokuroria Themelore në Gjakovë, Departamenti për Krime të Rënda, njofton opinionin publik, se me vendim të Prokurorit të Shtetit, ka ndaluar për 48 orë, të pandehurit A.Gj., D.N., dhe E.Q., për shkak të dyshimit të bazuar se në cilësinë e Inspektorëve të ATK-së, në periudha të ndryshme kohore dhe në lokacione të ndryshme në Gjakovë, kishin kërkuar dhe pranuar ryshfet nga pronarë të ndryshëm të bizneseve, me këto veprime formohet dyshimi i bazuar se të njëjtët kanë kryer veprën penale “Marrja e ryshfetit” nga neni 421 i KPRK-së.

Prokuroria Themelore Gjakovë, ka ndërmarr veprime hetimore, duke zbatuar edhe masat e veçanta hetimore, ndaj të njëjtëve.

Sipas kërkesës së Prokurorisë Themelore Gjakovë, dhe me urdhëresë të Gjykatës Themelore Gjakovë, me dt.20.01.2025, është kryer bastisje në tri (3) lokacion të ndryshme.

Prokuroria Themelore në Gjakovë, njofton se ndaj të pandehurve A.Gj., D.N., dhe E.Q., brenda afatit ligjor, do të paraqesë kërkesë për caktimin e masës së paraburgimit në Gjykatën kompetente.

Aktakuzë kundër një personi për veprën penale blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve, substancave psikotrope dhe analoge



PROKURORIA THEMELORE GJAKOVË




Aktakuzë kundër një personi për veprën penale blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve, substancave psikotrope dhe analoge

Gjakovë, 22 janar 2025

Prokuroria Themelore në Gjakovë, Departamenti i Krimeve të Rënda, ka ngritur aktakuzë, kundër të pandehurit E.Ç.

Sipas aktakuzës ndër tjera cekët se i pandehuri E.Ç., nga data e pacaktuar e gjerë me datë 30.06.2023, në fshatin Devë Komuna e Gjakovës, në bashkëveprim me të dënuarin J.B., pa autorizim dhe me qëllim shitje shpërndajnë, shesin, transportojnë substanca apo preparate të



cilat me ligj janë shpallur si narkotikë, në atë mënyrë që i pandehuri E.Ç., duke i koordinuar veprimet me të dënuarin J.B., i njëjti transporton narkotikun nga Shqipëria në Kosovë, përmes rrugëve malore dhe e njëjta substancë deponohet në shtëpinë e të dënuarit J.B., e ku nga kjo shtëpi lehtë kalohet në territorin e Republikës së Shqipërisë në këmbë për rreth 40 min, ashtu që i pandehuri E.Ç., i gjen dhe kontakton blerësit e mundshëm të narkotikut, kontakton me të dënuarin J.B., duke u siguruar se a ndodhet në shtëpi, pasi blerësi do të shkojë për të marrë substancë narkotike, e pastaj duke e udhëzuar të dënuarin J.B., që të shkoj t'i marr blerësit në vende të caktuara nga i pandehuri E.Ç., dhe t'i dërgoj në shtëpinë e tij, si dhe duke e udhëzuar për sasinë e substancës narkotike që do t'iu jap blerësve.


Gjatë bastisjes pas shtëpisë së të dënuarit J.B., janë gjetur dy çanta me substanca narkotike, njëra më ngjyrë të gjelbër me 17 paketime të mbushura me Kanabis (Marihuanë) dhe tjetra çantë ngjyrë e zezë, me 15 paketime të mbushura po ashtu Kanabis (Marihuanë), në peshë të përgjithshme 32 kg e 092 gram, substanca kjo e transportuar nga i pandehuri E.Ç., nga Republika e Shqipërisë.

Sa i përket bashkëkryerësit, përkatësisht ndajë të dënuarit J.B., çështja penale është veçuar dhe është përfunduar me aktgjykim dënues, ndërsa i pandehuri E.Ç., ka qenë në arrati deri me dt.31.12.2024, e nga kjo datë e deri me tani ndodhët nën masën e paraburgimit.

Me këto veprime në bashkëveprim i pandehuri E.Ç., ka kryer veprën penale “Blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve, substancave psikotrope dhe analoge” nga neni 267 par.2 e lidhur me nenin 31 të KPRK-së.

Prokurori i çështjes, me rastin e ngritjes së aktakuzës, i ka propozuar gjykatës që të pandehurin ta shpallë fajtor dhe të dënohet sipas ligjit për veprën penale e cila i vihet në barrë.

Kërkesë për paraburgim ndaj një të pandehuri për veprën penale vrasja në tentativë



Gjakovë, 2 shkurt 2025

Prokuroria Themelore në Gjakovë, Departamenti për Krime të Rënda, njofton opinionin publik se ndaj të pandehurit me inicialet E.Th., ka marrë Aktvendim për fillimin e hetimeve si dhe ka paraqitur, kërkesë në Gjykatën Themelore në Gjakovë, për caktimin e masës së paraburgimit në kohëzgjatje prej 30 ditësh.

Sipas kërkesës së Prokurorisë, ndër të tjera ceket se ekziston dyshimi i bazuar se i pandehuri me inicialet E.Th., me datë 01.02.2025 rreth orës 10:25 në Gjakovë Rr.“Yll Morina”, saktësisht në lokalit “E...”, me dashje ka tentuar të privoj nga jeta të dëmtuarin A.J., në atë mënyrë që ditën kritike i pandehuri në cilësi të pronarit të lokalit derisa ka qenë duke shërbyer klientët, pas një mosmarrëveshje me të dëmtuarin, në atë moment në fjalosje e sipër, i pandehuri me mjetë të mprehtë – thikë e sulmon të dëmtuarin duke e goditur disa herë në pjesët

vitale të trupit kryesisht rreth stomakut, ku si pasojë e lëndimeve të pësuar nga goditjet me thikë, i dëmtuari menjëherë dërgohet në emergjencën e Spitalit Rajonal “Isa Grezda” në Gjakovë, dhe më pas për shkak të gjendjes së rëndë shëndetësore, dërgohet në QKUK për trajtim mjekësor.

Këto veprime formojnë dyshimin e bazuar se i pandehuri ka kryer veprën penale, “Vrasja në tentative” nga neni 172 lidhur me nenin 28 të KPRK-së.

Njoftim



Gjakovë, 2 shkurt 2025

Prokuroria Themelore në Gjakovë, në lidhje me ngjarjen tragjike që ka ndodhur në fshatin Jabllanicë, Komuna e Gjakovës, informon publikun se dje në mesnatë nga Policia e Kosovës, jemi njoftuar se është shembur një objekt i pabanuar, duke rezultuar me humbjen e jetës së tre (3) personave të mitur, të cilët fatkeqësisht ndodheshin brenda tij në momentin e shembjes.

Në vendin e ngjarjes kanë dalë Kryeprokurori, prokurori kujdestar, të gjitha njësit përkatëse të Policisë së Kosovës, si dhe ekipi mjekësor që ka konfirmuar vdekjen e fëmijëve.

Me vendim të Prokurorit të Shtetit, trupat e pajetë janë dërguar për obduksion në Institutin e Mjekësisë Ligjore (IML), si dhe është inicuar rast “Shkaktimi i rrezikut të përgjithshëm”.

Prokurori i Shtetit, në koordinim të ngushtë me Policinë e Kosovës, po ndërmerret të gjitha veprimet e nevojshme për zbardhjen e këtij rasti.

Takim lidhur me bashkëpunimin ndërinstytucional



Gjakovë, 4 shkurt 2025

Kryeprokurori i Prokurorisë Themelore në Gjakovë, z. Enis Gashi, së bashku me disa nga prokurorët e kësaj prokurorie, mbajti një takim të rëndësishëm me Kryetarin e Gjykatës Themelore në Gjakovë, z. Nikollë Komani, Drejtorin e Policisë Rajonale në Gjakovë, z. Lumni Graishta, si dhe komandantët e Stacioneve Policore të Gjakovës, Rahovecit dhe Malishevës.

Në këtë takim, ndër tjera u diskutua rreth vazhdimit dhe forcimit të bashkëpunimit në mes Prokurorisë, Policisë dhe Gjykatës, për të garantuar një realizim sa më efikas të ushtrimit të detyrave dhe përmbushjen e obligimeve ligjore, për një punë të përbashkët për t'u përballur me sfidat aktuale në fushën e drejtësisë dhe sigurisë.

Po ashtu, një tjetër temë e rëndësishme e diskutuar ishte angazhimi dhe koordinimi i përbashkët i institucioneve lidhur me mbrojtjen e votës së lirë të qytetarëve, në zgjedhjet nacionale që do të mbahen më 9 shkurt 2025, me qëllim të përcaktimit të masave të duhura për të siguruar rendin dhe sigurinë gjatë periudhës zgjedhore, si dhe për të garantuar një proces të lirë dhe të drejtë për qytetarët.

Në fund të takimit nga të gjithë të pranishmit është theksuar rëndësia e bashkëpunimit të ngushtë mes institucioneve të drejtësisë dhe sigurisë, për krijimin e një mjedisi të sigurt dhe të besueshëm për qytetarët, si dhe për përballimin e çdo sfide që mund të lindë gjatë realizimit të detyrave të tyre përkatëse ligjore.



Kërkesë për paraburgim për dhunë në familje



PROKURORIA THEMELORE GJAKOVË

KËRKESE PËR PARABURGIM PËR DHUNË NË FAMILJE


28 shkurt 2025



Gjakovë, 28 shkurt 2025

Prokuroria Themelore në Gjakovë, Departamenti i Përgjithshëm, njofton opinionin publik se ndaj të pandehurit me inicialet G.G., ka marrë Aktvendim për fillimin e hetimeve si dhe ka paraqitur, kërkesë në Gjykatën Themelore në Gjakovë, për caktimin e masës së paraburgimit në kohëzgjatje prej 30 ditësh.

Sipas pikës I të dispozitivit të kërkesës, ndër të tjera ceket se ekziston dyshimi i bazuar se i pandehuri me inicialet G.G., me datë 26.02.2025, rreth orës 13:00 në rr. “I.G.” në Gjakovë saktësisht në shtëpinë e tij, seriozisht dhe me armë AK 47 e kanos të dëmtuarën bashkëshorten e tij E.G., dhe të dëmtuarin I.H., i cili është vëllai i bashkëshortes së tij se do ti privojë nga jeta, në atë mënyrë që ditën kritike derisa kishin qenë duke ndenjur në sallon midis tyre nis një mosmarrëveshje me të dëmtuarën – bashkëshorten e tij E.G., për shkaqe xhelozie.



Këto veprime formojnë dyshimin e bazuar se i pandehuri ka kryer veprën penale “Kanosja” nga neni 181 prg.4 lidhur me prg.2 të KPRK-së.

Sipas pikës II të dispozitivit të kërkesës, ndër të tjera ceket se ekziston dyshimi i bazuar se i pandehuri me inicialet G.G., me datë 26.02.2025 rreth orës 13:00 në rr. “I.G.” në Gjakovë saktësisht në shtëpinë e tij, me dashje dhe me mjet të rrezikshëm (thikë) me të cilin mund të shkaktojë lëndim të rënd trupor ose dëmtim të rëndë të shëndetit ushtron keqtrajtimin fizik, me qëllim që t’i shkaktoj lëndime trupore personit tjetër dhe atë viktimës së ndjeshme – bashkëshortes së tij E.G., me ç’rast të dëmtuarës i shkakton lëndime të lehta trupore të përshkruara sipas raportit mjekësor të lëshuar nga Spitali Rajonal “Isa Grezda” në Gjakovë.

Këto veprime formojnë dyshimin e bazuar se i pandehuri ka kryer veprën penale “Lëndimi i lehtë trupor” nga neni 185 prg.3 nënprg.3.2 lidhur me prg.2 dhe prg.1 të KPRK- së.

Sipas pikës III të dispozitivit të kërkesës, ndër të tjera ceket se ekziston dyshimi i bazuar se i pandehuri me inicialet G.G., nga koha e pavërtetuar e deri me datë 26.02.2025 në rr. “I.G.” në Gjakovë, saktësisht në shtëpinë e tij, pa autorizim ka mbajtur në posedim armë dhe municion në kundërshtim me ligjin e zbatueshëm lidhur me armët nr.05/L-022.

Këto veprime formojnë dyshimin e bazuar se i pandehuri ka kryer veprën penale “Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve” nga neni 366 prg.1 të KPRK-së.

Aktakuzë kundër pesë personave për keqpërdorim i pozitës apo autoritetit zyrtar



PROKURORIA THEMELORE GJAKOVË

AKTAKUZË KUNDËR PESË PERSONAVE PËR KEQPËRDORIM I POZITËS APO AUTORITETIT ZYRTAR


3 mars 2025



Gjakovë, 3 mars 2025

Prokuroria Themelore në Gjakovë, Departamenti për Krime të Rënda, njofton opinionin publik, se ka ngritur aktakuzë, kundër të pandehurve me inicialet H.Ç., M.U., S.M., Z.V., A.H., për veprën penale “Keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar” nga neni 414 par.1 lidhur me nenin 31 të KPRK-së.

Sipas aktakuzës ndër tjera cekët se të pandehurit me inicialet H.Ç., M.U., S.M., Z.V., A.H., me datë të pacaktuar e deri në fillim të muajit qershor të vitit 2024, në cilësinë e personave zyrtar pranë Kompanisë Rajonale të Ujësjellësit K.R.U “Gjakova” SH.A – Dega në Rahovec, kanë shfrytëzuar detyrën apo autoritetin zyrtar duke i tejkaluar kompetencat zyrtare me qëllim të përfitimit për vete apo personin tjetër dobi pasurore të kundërligjshme, të cilët të koordinuar në mes vete, në dëm të Kompanisë Rajonale të Ujësjellësit K.R.U “Gjakova” SH.A, kryejnë



shërbime në komunë të Rahovecit, tek qytetarët e saj gjatë orarit të punës dhe jashtë tij pa dijeninë e kompanisë, në atë mënyrë kanë shfrytëzuar: kamionin, eskavatorin, derivatin dhe materialin e nevojshëm për kyqjen e ujësjellësit tek qytetarët me të cilët kishin biseduar tani të pandehurit gjegjësisht, H.Ç., i koordinuar me të pandehurin S.M., të pandehurin Z.V., dhe të pandehurit A.H., dhe M.U., kanë marrë për shërbimet e kryera tek qytetarët si, L.O., shumë prej 1.500 euro, G.D., shumë prej 350 euro, H.D., shumë prej 750 euro, A.A., shumë prej 1.000 euro dhe P.M., shumë prej 2.000 euro, të holla këto të cilat janë ndarë në mes të pandehurit H.Ç., dhe S.M., ndërsa në pagesa më të vogla u janë dhënë tre të pandehurve të tjerë, me çka në këtë mënyrë me veprimet e tyre të kundërligjshme të njëjtit i shkaktojnë dëm material të dëmtuarës K.R.U “Gjakova” SH.A.

Me këto veprime në bashkëkryerje kanë kryer veprën penale “Keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar” nga neni 414 par.1 lidhur me nenin 31 të KPRK-së.

Prokurori i çështjes me rastin e ngritjes së aktakuzës, i ka propozuar gjykatës që të pandehurit të shpallën fajtor dhe të dënohet sipas ligjit për veprën penale e cila i’u vihet në barrë, si dhe ti shqiptohet dënimi plotësues – Ndalimi i ushtrimit të funksioneve në administratën publike ose shërbimin publik.


Aktakuzë për vrasje në tentativë



PROKURORIA THEMELORE GJAKOVË

AKTAKUZË PËR VRASJE NË TENTATIVË


6 mars 2025



Gjakovë, 6 mars 2025

Prokuroria Themelore në Gjakovë, Departamenti për Krime të Rënda, njofton opinionin publik, se ka ngritur aktakuzë, kundër të pandehurit me inicialet P.B., për veprat penale “Vrasja në tentativë” nga neni 172 lidhur me nenin 28 të KPRK-së, dhe “Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve” nga neni 366 par.1 të KPRK-së.

Sipas pikës I të dispozitivit të aktakuzës, ndër tjera cekët se i pandehuri me inicialet P.B., me datë 20.12.2024, rreth orës 09:30 minuta, rruga “D” Brekoc – Gjakovë, me dashje dhe me armë zjarri ka tentuar të privojë nga jeta këtu të dëmtuarin Gj.B, ashtu që si shkak i një mosmarrëveshje pronësore të mëhershme, e cila mosmarrëveshje ka vazhduar edhe ditën kritike, kur i dëmtuari shkon të bisedoj më të pandehurin që të merren vesh, pasi të njëjtit takohen tek rrethoja e oborrit të pandehurit, fillimisht fjalosen dhe për një moment i pandehuri nxjerr nga brezi pistoletën e llojit Sig Sauer e kalibrit 9×19 mm, kur i dëmtuari i vëren armën



të pandehurit fillon të largohet me vrap, e gjatë ikjes i pandehuri nga prona e tij, hip në themelin e rrethojës e mbi rrethojë në një distancë rreth 3 metra shtënë në drejtim të dëmtuarit, ku e godet në regjionin e poshtëm të shpinës.

Me këto veprime ka kryer veprën penale “Vrasja në tentative” nga neni 172 lidhur me nenin 28 të KPRK-së.

Sipas pikës II të dispozitivit të aktakuzës, ndër tjera cekët se i pandehuri me inicialet P.B., ka mbajtur në posedim të paautorizuar armën, në kundërshtim me nenin 4 par.1 nën par.1.1 Ligjin mbi armët të Republikës së Kosovës.

Me këto veprime ka kryer veprën penale “Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve” nga neni 366 par.1 të KPRK-së.

Prokurori i çështjes me rastin e ngritjes së aktakuzës, i ka propozuar gjykatës që të pandehurin ta shpallë fajtor dhe të dënohet sipas ligjit për veprat penale të cilat i vihen në barrë.

Nxënësit e SH.M.L.E “Kadri Kusari” Vizituan Prokurorinë Themelore të Gjakovës



Gjakovë, 7 mars 2025

Kryeprokurori z. Enis Gashi dhe Administratorja znj. Elida Tabaku, me kërkesë të Shkollës së Mesme të Lartë Ekonomike “Kadri Kusari” – Gjakovë-Drejtimi Juridik, realizuan një takim informues me nxënësit e kësaj shkolle, ata patën mundësinë të njihen më nga afër me organizimin e Prokurorisë Themelore në Gjakovë.

Ky takim u zhvillua në objektin e Prokurorisë dhe pati për qëllim rritjen e njohurive të nxënësve mbi rolin dhe detyrat e Prokurorit të Shtetit, ku nxënësit e kësaj shkolle më konkretisht u informuan lidhur me funksionimin e Prokurorisë dhe bashkëpunimin me institucionet e tjera të drejtësisë, gjatë takimit u diskutua gjithashtu për trajtimin e rasteve penale, procedurat hetimore etj.

Ky aktivitet shërbeu si mundësi për nxënësit që të kuptojnë më mirë sistemin e drejtësisë në aspektin praktik dhe bashkëpunimin midis institucioneve, duke rritur ndërgjegjësimin për rëndësinë e respektimit të ligjit dhe të drejtave të njeriut.


Aktakuzë për vrasje të rëndë në tentativë



Gjakovë, 26 mars 2025

Prokuroria Themelore në Gjakovë, Departamenti për Krime të Rënda, njofton opinionin publik, se ka ngritur aktakuzë, kundër të pandehurit me inicialet K.Z., për veprat penale “Vrasja e rëndë e mbetur në tentativë” nga neni 173 par.1. nën par.1.5., lidhur me nenin 28 të KPRK-së, dhe “Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve” nga neni 366 par.1. të KPRK-së, ndërsa për të pandehurin me inicialet V.K., për veprën penale “Lëndimi i lehtë trupor” nga neni 185 par.1. lidhur me nën par.1.4. të KPRK-së.

Sipas aktakuzës, ndër të tjera cekët se i pandehuri K.Z., me datë 10.01.2025, rreth orës 02:30-03:00/h, në lokalin “T...” në fshatin Tërpezë, Komuna Malishevë, me dashje ka tentuar të privojë nga jeta të dëmtuarin V.K., duke vënë në rrezik edhe jetën e personave të tjerë, ne atë mënyrë natën kritike lidhur me një mos marrëveshje të momentit, në fjalosje e sipër janë grushtuar në mes vete, ku pason përleshja mes tyre dhe aty ndërhyjnë për ti ndarë i dëmtuari



E.B., mirëpo në ato momente i pandehuri K.Z., nga brezi nxjerrë armën e zjarrit të tipit ‘NN’, kalibër NN, për të shtënë në të mirëpo pengohet nga E.B., i cili i vë dorën mbi revole, ja kapë dorën dhe nuk ja lëshon me atë rast i pandehuri ka shtënë një herë por që gjatë asaj gjuajtje lëndohet i dëmtuari E.B., në dorë të djathtë, aty kanë ndërhyrë po ashtu të pranishmit ku e kapin për duar dhe krahu, të pandehurin K.Z., ku arrijnë ta ndalojnë, i pandehuri ka dalë nga lokali dhe është larguar nga lokali me veturën e tij.

Me këto veprime ka kryer veprën penale “Vrasja e rëndë e mbetur në tentativë” nga neni 173 par.1. nën par.1.5., lidhur me nenin 28 të KPRK-së, dhe veprën penale “Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve” nga neni 366 par.1. të KPRK-së.

Ndërsa i pandehuri V.K., në vendin dhe kohën e njëjtë, nga përleshje me K.Z., e ka grushtuar K.Z., dhe i shkakton lëndime të lehta trupore të konstatuar në raportin e ekspertizës mjekoligjore.

Me këto veprime ka kryer veprën penale “Lëndimi i lehtë trupor” nga neni 185 par.1. lidhur me nën par.1.4. të KPRK-së.

Prokurori i çështjes me rastin e ngritjes së aktakuzës, i ka propozuar gjykatës që të pandehurit të shpallën fajtor dhe të dënohen sipas ligjit për veprat penale të cilat ju vihen në barrë.

Prokuroria Themelore në Gjakovë organizon takim në kuadër të Strategjisë Kombëtare kundër Trafikimit me Njerëz në Kosovë 2022-2026




Gjakovë, 27 mars 2025

Prokuroria Themelore në Gjakovë, në kuadër të Strategjisë Kombëtare kundër Trafikimit me Njerëz në Kosovë 2022-2026, ka organizuar sot një takim me akterët relevantë që merren me trajtimin e rasteve të trafikimit me njerëz dhe veprave penale kundër integritetit seksual. Ky takim ka për qëllim forcimin e bashkëpunimit dhe koordinimit ndër-institucional.

Në këtë takim të organizuar nga Prokuroria Themelore në Gjakovë, pjesëmarrësit u pritën nga Kryeprokurori, z. Enis Gashi, së bashku me prokurorin koordinator për veprat penale kundër trafikimit me njerëz, z. Anton Hasanaj, dhe prokurorin koordinator për veprat penale kundër integritetit seksual, z. Sadri Alija.

Gjatë këtij takimi, përfaqësues nga institucione të ndryshme, përfshirë Policia e Kosovës, Zyra për Mbrojtje dhe Ndihmë Viktimave, Qendra për Punë Sociale, Qendra e Shëndetit Mendor, Shtëpia e Sigurt, si dhe OJQ “Femrat Aktive të Gjakovës”, diskutuan çështjet e zbatimit të Strategjisë Kombëtare Kundër Trafikimit me Njerëz në Kosovë 2022-2026, bashkëpunimi dhe



koordinimi në mes këtyre institucioneve, në ndërmarrjen e veprimeve dhe masave konkrete, me qëllim të identifikimit të sfidave dhe përmirësimit të gjendjes në parandalimin dhe luftimin efikas të trafikimit me njerëz dhe veprat penale kundër integritetit seksual.

Prokuroria Themelore e Gjakovës, mbetet e përkushtuar në forcimin e bashkëpunimit dhe angazhimit të përbashkët për luftimin e këtyre dukurive negative, duke siguruar mbrojtjen dhe ndihmën e nevojshme për viktimat.

Kërkohet paraburgimi ndaj të pandehurit për veprën penale ngacmimi seksual



Gjakovë, 28 mars 2024

Prokuroria Themelore në Gjakovë, Departamenti i Përgjithshëm, njofton opinionin publik se ndaj të pandehurit me inicialet D.Ll., ka marr aktvendim për fillimin e hetimeve dhe ka paraqitur kërkesë, në Gjykatën Themelore në Gjakovë, për caktimin e masës së paraburgimit në kohëzgjatje prej 30 ditësh .

Sipas kërkesës së Prokurorisë, ndër të tjera ceket se ekziston dyshimi i bazuar se i pandehuri me inicialet D.Ll., me datë 26.03.2025 në Gjakovë, saktësisht në Shkollën Fillore të Ulët "M.K.", e ngacmon seksualisht personin tjetër, e cila është e ndjeshme për shkak të moshës, duke u përfshirë në sjellje të padëshiruar verbale të natyrës seksuale ndaj të dëmtuarës/e mitur, veprime këto me të cilat të dëmtuarës/e mitur, i ka cenuar dinjitetin dhe ka krijuar mjedis objektivisht frikësues, degradues dhe poshtërues

Me këto veprime formohet dyshimi i bazuar se i pandehuri ka kryer veprën penale Ngacmimi Seksual nga neni 183 par. 4, lidhur me par.1 të KPRK-së.